



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 75, DATË 03.09.2020

PËR

SHTYRJEN E VENDIMMARRJES PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR
NDRYSHIMET E NDODHURA NË STRUKTURËN E PRONËSISË SË
SHOQËRISË “CHANNEL ONE” SH.P.K., LICENCUAR PËR SUBJEKTIN
AUDIOVIZIV “TV ORA NEWS”

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Shoqëria “Channel One” sh.p.k.

Objekt: Mbi ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Channel One” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat “Tv Ora News”.

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16 i ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VËREN SE:

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbledhjen e datës 03 shtator 2020, mori në shqyrtim relacionin dhe projektvendimin: “Mbi ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Channel One” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat “Tv Ora News”.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (sot Autoriteti i Mediave Audiovizive) me vendimin nr. 29/8, datë 30.10.2000, ka licencuar shoqërinë “Teknotrade LTD” sh.p.k., për subjektin audioviziv “Tv Tele I”. AMA, me vendimet nr. 83, datë 31.10.2003 dhe nr. 772, datë 30.01.2009,

i ka rinovuar licencën këtij subjekti. Subjekti ka ndryshuar emrin e subjektit tregtar nga "Teknotrade" në "Channel One" në vitin 2010 (referuar Ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit). AMA me vendimin nr. 117, datë 08.06.2016, i ka rinovuar dhe zëvendësuar licencën shoqërisë "Channel One" sh.p.k. AMA, me vendimin nr. 58, datë 05.08.2020 ka ndryshuar emrin e shërbimit të programit audioviziv nga "Tv Channel One" në "Tv Ora News".

Nga verifikimi i kryer nga AMA rezulton se, ortaku i vetëm i shoqërisë "Channel One" sh.p.k., z. Ylli Ndroqi zotëron edhe 60% të aksioneve në shoqërinë "Ora" sh.a. (licencuar për shërbim audio dhe audioviziv).

Nga ana tjetër, në nenin 62 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcaktohet: "*Një person fizik ose juridik që ka aksione në një subjekt që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë që zotëron një licencë transmetimi audioviziv lokale apo rajonale.* Gjendur në këto kushte, AMA, kërkoi nga subjekti marrjen e masave për kryerjen e ndryshimeve në strukturën e pronësisë, për të qenë në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në ligjin e posaçëm.

Në vijim, shoqëria "Channel One" sh.p.k., me shkresën nr. 1284 prot., datë 21.03.2019 ka depozituar njoftimin lidhur me ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë, nëpërmjet të cilit Ylli Ndroqi, ortak me 100% të kuotave në këtë shoqëri, ka kaluar 70% të kuotave tek Astrit Sejdini. Struktura e shoqërisë "Channel One" sh.p.k., ndryshon si më poshtë: Ylli Ndroqi me 30% të kuotave dhe Astrit Sejdini me 70% të kuotave.

Shoqëria "Channel One" sh.p.k., me shkresën nr. 1284 prot., datë 21.03.2019, ka depozituar njoftimin lidhur me ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë, nëpërmjet të cilit Ylli Ndroqi, ortak me 100% të kuotave në këtë shoqëri, ka kaluar 70% të kuotave tek Astrit Sejdini. Struktura e shoqërisë "Channel One" sh.p.k., bëhet Ylli Ndroqi me 30% të kuotave dhe Astrit Sejdini me 70% të kuotave. Bashkëlidhur njoftimit, subjekti ka depozituar dokumentacionin si më poshtë:

- Ekstraktin Historik të shoqërisë "Channel One" sh.p.k., të datës 19.03.2019, nga i cili rezulton se: Shoqëria është regjistruar si e tillë në datën 12.12.2001. NIPT i subjektit është: K1212002L. Objekti i aktivitetit është: "*Projektimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara...*". Vendi i ushtrimit të aktivitetit: Rruga "Aleksandër Moisiu", ish Kinostudio, Tiranë. Ortakët e shoqërisë janë: Ylli Ndroqi me 30% të kuotave dhe Astrit Sejdini me 70% të kuotave. Administrator i shoqërisë Ylli Ndroqi. Nr. cel: 0692055369; email: jurist@yldon.net. Statusi: Aktiv.
- Kontratën e shitjes së kuotave me nr. 1802 rep. dhe nr. 750 kol., e lidhur në datë 15.03.2019, nëpërmjet të cilës z. Ylli ndroqi (ortak me 100% të kuotave), i shet 70% të kuotave z. Astrit Sejdini, me çmim 2,450,000 lekë.

Po ashtu, në datën 18.03.2019, referuar Ekstraktit Historik të Regjistrimit Tregtar të QKB-së në datën 19.03.2019 subjekti ka ndryshuar strukturën e pronësisë si më poshtë: "*... Është shtuar ortaku Astrit Sejdini. Numri i kuotave është 1.00. Përqindja në kapital 70.00. Kontributi në para 2.450.000.00. Kanë ndryshuar të dhënat për Ylli Ndroqi. Kontributi në para ishte 3.500.000.00 u bë 1.050.000.00. Përqindja në kapital ishte 100.00 u bë 30.00*".

Pra struktura e pronësisë së shoqërisë "Channel One" sh.p.k., është:

- Z. Astrit Sejdini, ortak me (70%) të kuotave;
- Z. Ylli Ndroqi, ortak me (30%) të kuotave.

AMA, me shkresën nr. 1284/1 prot. datë 03.04.2019, ka kërkuar nga shoqëria “Channel One” sh.p.k., plotësimin e njoftimit lidhur me ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë duke kërkuar depozitim e:

1. Vërtetim mbi eksperiencat e punës të ortakut të ri të shoqërisë “Channel One” sh.p.k., vërtetim prej institucioneve tatimore dhe/ose sigurimeve shoqërore mbi kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat etj, të derdhura në favor të tij;
2. Vërtetimin e gjendjes gjyqësore të z. Astrit Sejdini, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të ortakut të ri të shoqërisë “Channel One” sh.p.k. (dëshminë e penalitetit).

Në vijim të njoftimit të sipërcituar, subjekti me shkresën nr. 1284/2 prot., datë 17.04.2019, dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

1. Vërtetimin nr. T00977382, datë 11.04.2019, se nga personi fizik Astrit Sejdini me NIPT: L31930003K, janë paguar kontribute për shlyerjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të z. Astrit Sejdini për periudhën janar 2018 - mars 2019.
2. Vërtetimin nr. T00977364, datë 11.04.2019, se nga shoqëria “Ora” sh.a., me NIPT: K71505003O, janë paguar kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për z. Astrit Sejdini për periudhën janar 2018- shkurt 2019.
3. Vërtetimin e gjendjes gjyqësore të z. Astrit Sejdini të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me nr. 11 prot., datë 11.04.2019, nga i cili rezulton se është i padënuar.

Referuar të dhënave të kontratës së shitjes së kuotave, rezulton se vlera e blerjes së tyre ë është 2,450,000 lekë. Në lidhje me burimet financiare të blerjes së kuotave nga z. Astrit Sejdini, në masën 2,450,000 lekë, janë deklaruar vetëm të ardhurat nga pagat e marra nga shoqëria “ORA” sh.a., sipas Vërtetimit për shlyerjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të z. Astrit Sejdini për periudhën janar 2018 - shkurt 2019 (nr. T00977364, datë 11.04.2019), në masën neto 301,920 lekë. Kjo shumë nuk justifikon vlerën për blerjen e kuotave nga ana e z. Astrit Sejdini.

Anëtarët e AMA-s propozuan shtyrjen e vendimmarrjes për këtë kërkesë duke mbajtur në konsideratë situatën në të cilën gjendet ky subjekt për shkak të vendosjes në sekuestro të aksioneve të ortakut Ylli Ndroqi, si në shoqërinë “Channel One” sh.p.k. dhe në shoqërinë “Ora” sh.a., si dhe për një shqyrtim me të hollësishëm të dokumentacionit shoqërues të praktikës administrative.

Në përfundim, anëtarët e AMA-s ranë dakord në mënyrë unanime të shtyjnë diskutimin dhe vendimmarrjen për ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Channel One” sh.p.k., licencuar për subjektin audioviziv “Tv Ora News”

PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Të shtyjë vendimmarrjen për projektvendimin për ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë "Channel One" sh.p.k., licencuar për subjektin audioviziv "Tv Ora News".
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në zbatim të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian SALA

Zëvendëskryetar:

Sami NEZAJ

Anëtarë:

Agron GJEKMARKAJ

Gledis GJIPALI

Suela MUSTA